


Karjera e z. Maksut



Author:	Qamil Buxheli
Genre:	Uncategorized
Goodreads Rating:	4.67
Published:	1971 by Shtëpia Botuese ◇
Language	Albanian
Pages:	320

[Karjera e z. Maksut.pdf](#)

[Karjera e z. Maksut.epub](#)

z. Maksut Ramo, pasi kishte lënë përgjysëm, pesë vjet më parë, studimet në fakultetin tregëtar të Selanikut, ishte kthyer në Shqipëri dhe kishte pranuar si strehë (sa të pushonte shiu) postin e kryetarit të komunës së Tarinës, me shpresë se, me ndërhyrjen e disa miqve të oxhakut (i jati, Ali Ramo, qe atëhere një tregëtar i madh lëkurësh), do të mundte një ditë të siguronte postin e kryekonsullit ose të konsullit të mbretërisë shqiptare në ndonjë shtet të Evropës ose të Amerikës Latine. Mirëpo tregëtari i pafat i lëkurëve falimento, e bashkë me lëkurët sikur humbën edhe miqtë e oxhakut edhe “ëndrra diplomatike” e zotit Maksut. Kjo ëndërr zgjohet përsëri për zotin Maksut, kur ai merr një letër nga ministri, që njofton se z. David Jakobson, historiani personal i naltmadhënisë, Zogut I, do të vizitojë komunën e Tarinës, ku sipas informatave kishte qenë syrgjynosur për shkaqe politike xhaja i Lartmadhënisë së Tij Mbretit. Letra mbyllet me shënimin se kërkesat e zotit Maksut janë mbajtur në evidencë, por gjithshka do të varet para së gjithash, nga kurorëzimi me sukses nga ana e tij i udhëzimeve të qarkores së ministrit.